



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 211, datë 31.3.2021

P Ë R

PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E SUPERVIZIMIT E TË KOLAUDIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE
DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË
KAMZË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 14 820 655 (katërmbëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e supervizimit e të kolaudimit të rindërtimit dhe rikonstruksionit të 9 (nëntë) objekteve arsimore, si dhe të rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) të ndara me lote, në Bashkinë Kamzë.
2. Efekti financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".


KRYEMINISTRI

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE


MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ



NR.PROT. 1708/1
DATË 2.4. 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

